

Plant Health 4 Life campaign

Viti i 3-të i #PlantHealth4Life inkurajon qytetarët që të bëhen ambasadorë të shëndetit të bimëve

Autoriteti Evropian i Sigurisë Ushqimore (EFSA), Komisioni Evropian (KE) dhe partnerët e tyre anëmbanë Evropës kanë nisur vitin e tretë të fushatës #PlantHealth4Life, një nismë ndërkufitare për mbrojtjen e shëndetit të bimëve dhe për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut lidhur me rëndësinë e tyre për mjedisin, ekonominë dhe jetën tonë të përditshme.

Duke filluar nga Maji i vitit 2025, fushata sjell energji të reja dhe një fokus të ri, duke marrë shkas nga vrulli i dy viteve të mëparshme për të nxitur një angazhim edhe më të thellë, si brenda, ashtu përtej Bashkimit Evropian.

Parma, 12.05.2025

"Kur qytetarët kuptojnë rolin jetik që bimët luajnë në jetët e tyre — nga ushqimi në tryezat e tyre e deri te ajri që ata thithin — ata bëhen agjentë të fuqishëm të ndryshimit", shpjegon Sylvain Giraud, Kryetar i Sektorit të Shëndetit të Bimëve pranë Drejtorisë së Përgjithshme për Shëndetin dhe Sigurinë Ushqimore (DG SANTE). "#PlantHealth4Life është një rikujtim se secili prej nesh mund të bëjë një ndryshim të rëndësishëm duke u informuar vazhdimisht dhe duke bërë zgjedhje të kujdesshme që ndihmojnë në mbrojtjen e asaj që na mban gjallë".

"Një bimë nuk është thjesht një bimë — ajo mund të bartë edhe organizma të tjerë të gjallë", është shprehur Giuseppe Stancanelli, Kryetar i Ekipit për Vlerësimin e Rreziqeve ndaj Shëndetit të Bimëve pranë EFSA-s. "Në botën tonë të ndërlidhur, bimët udhëtojnë më shumë se kurrë. Prandaj, BE-ja mbështetet në vlerësimin e rreziqeve i bazuar te shkenca për të kuptuar dhe menaxhuar kërcënimet e mundshme ndaj shëndetit të bimëve — duke ndihmuar kështu në mbrojtjen e mjedisit, bujqësisë dhe biodiversitetit tonë. Përmes fushatës #PlantHealth4Life, ne po rrisim ndërgjegjësimin anëmbanë Evropës".

Me një fokus më të madh te pjesëmarrja, bashkëpunimi dhe fuqizimi i qytetarëve, këtë vit, fushata #PlantHealth4Life bashkon partnerë nga 26 shtete anëtare të BE-së, 5 vende në procesin e para anëtarësimit në BE dhe Zvicra, për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të frymëzuar të menduarit kritik lidhur me lidhjen jetike që ka shëndeti i bimëve me mjedisin dhe me jetën tonë të përditshme. Duke theksuar veprimin praktik dhe përfshirjen e komuniteteve, fushata inkurajon qytetarët e informuar jo vetëm që të reflektojnë, por edhe të ndajnë njohuritë e tyre dhe të frymëzojnë të tjerët për t'iu bashkuar përpjekjes kolektive për mbrojtjen e ekosistemeve dhe ekonomive tona.

Si ndikon shëndeti i bimëve në jetët tona?

Bimët përbëjnë 80% të ushqimit që konsumojmë, shërbejnë si ushqim për kafshët me të cilat ne ushqehemi, si dhe pastrojnë arin që thithim. Por jo vetëm kaq: bimët e shëndetshme nënkuptojnë edhe një rendiment të mirë bujqësor, gjë që ndikon te disponueshmëria e ushqimit dhe te çmimet e ushqimeve për konsumatorët. Ndryshimet klimatike dhe veprimtaritë njerëzore, si tregtia dhe udhëtimet, ushtrojnë presion të konsiderueshëm te bimët. Përhapja e parazitëve dhe sëmundjeve të bimëve mund të ketë pasoja shkatërruese ekonomike dhe mjedisore. Për shembull, përhapjet në masë të patogjenit bakterial *Xylella fastidiosa* kanë mbi një dekadë që shkatërrojnë ullishtet e



Italisë jugore, duke shkaktuar humbjen e miliona pemëve dhe duke kërcënuar biodiversitetin dhe ekonominë vendore.

Megjithatë, ka ende shumë qytetarë të painformuar për rëndësinë e shëndetit të bimëve. #PlantHealth4Life synon të rrisë ndërgjegjësimin kolektiv lidhur me rreziqet ndaj shëndetit të bimëve, si dhe lidhur me rolin që mund të luajë gjithsecili prej nesh për mbrojtjen e bimëve.

Andrzej Chodkowski, Kryeinspektor i Shëndetit të Bimëve në Poloni, nxit "çdo person që të bashkëpunoj dhe të kujdeset për bimët në mjedisin e tij rrethues, në mënyrë që të mund të gëzojmë gjelbërimin e tyre të pasur dhe ta kthejmë së bashku në realitet mesazhin: "Mbroni bimët, mbroni jetën!"

Shpërndani mesazhin dhe bëhuni pjesë!

Veprimet e çdo qytetari evropian janë thelbësore për ruajtjen e shëndetit të bimëve. Vizitoni [faqen e internetit të fushatës #PlantHealth4Life](#) dhe zbuloni se si fushata nxit publikun që të mbrojë shëndetin e bimëve. Burimet përfshijnë materiale për shtyp, postime në mediat sociale dhe video.

Fushata është e hapur për të gjithë, me një fokus të veçantë te:

- **Udhëtarët kureshtarë**, të cilëve u pëlqen të eksplorojnë botën dhe natyrën.
- **Kopshtarët**, të cilët kultivojnë dhe kujdesen për perimet, lulet dhe pemët e shtëpisë.
- **Prindërit**, të cilët janë të shqetësuar për ushqimin që konsumojnë fëmijët e tyre dhe janë të përkushtuar ndaj mbrojtjes së komuniteteve bujqësore, mjedisit dhe biodiversitetit për brezat e ardhshëm.

Këtë vit, **#PlantHealth4Life** do të jetë sërish e pranishme nëpër panaire, ekspozita dhe shkolla në vendet pjesëmarrëse. Vizitoni faqen zyrtare të internetit të fushatës për të parë aktivitetet që po zhvillohen në vendin tuaj dhe na ndiqni për të marrë më shumë informacione në kohë reale!

Rreth fushatës

#PlantHealth4Life është një fushatë shumëkombëshe disavjeçare, e zhvilluar me kërkesë të Komisionit Evropian dhe e bazuar në një [analizë të thelluar](#) të perceptimeve dhe sjelljeve të qytetarëve lidhur me shëndetin e bimëve në mbarë BE-në. Fushata po zgjerohet vazhdimisht në qëllimin dhe shtrirjen së saj, duke mirëpritur 10 pjesëmarrës të rinj në vitin 2025: **Austria, Bullgaria, Italia, Holanda dhe Rumania** u bashkohen 21 shteteve anëtare ekzistuese të BE-së: Belgjikës, Kroacisë, Qipros, Çekisë, Danimarkës, Estonisë, Finlandës, Francës, Gjermanisë, Greqisë, Hungarisë, Irlandës, Letonisë, Lituanisë, Maltës, Polonisë, Portugalisë, Sllovakisë, Sllovenisë, Spanjës, Suedisë dhe Malit të Zi. Katër shtete të reja në proces paraanëtarësimi: **Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kosova*** dhe **Turqia** i bashkohen Malit të Zi si pjesëmarrëse në fushatën #PlantHealth4Life, së bashku me **Zvicrën**.

***Ky emërtim nuk cenon qëndrimet për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Deklaratën e Pavarësisë të Kosovës.**